

VENDIM
Nr. 516, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE QË DO TË FINANCOHEN NGA FONDI I SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË SHËRBIMIN SPITALOR”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kontraktimi me institucionet shëndetësore jopublike për financimin e paketave bëhet në përputhje me legjislacionin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, duke aplikuar nëpërmjet platformës *e-Albania*.”.

2. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Fondi administron Regjistrin Kombëtar të Paketave të Shërbimeve Shëndetësore të autorizuar në institucionet shëndetësore jopublike, Regjistrin Kombëtar të Paketës Shëndetësore të Hemodializës në qendrat e ofrimit të këtij shërbimi nga kontrata e partneritetit publik privat, si dhe regjistrin e të dhënave për paketat shëndetësore të realizuara në nivel kombëtar.”.

II. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama